



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**

*Kuvendi - Skupština - Assembly*

---

**Legjislatura III**

Komisioni për Integritime Evropiane  
Mbledhja nr. 18  
Prishtinë, më 21.10.2008, ora 12:00  
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-10

**PROCESVERBAL**  
**i mbledhjes së Komisionit për Integritime Evropiane**

Në mbledhje morën pjesë: Zylfije Hundozi, Džezair Murati, Hydajet Hyseni, Edita Tahiri, Sabri Hamiti, Fatmir Rexhepi, Njomza Emini, Nait Hasani, Naser Rugova, ndërsa munguan Bujar Bukoshi dhe Branislav Grbić.

Pjesëmarrës të tjerë: nga OSBE - Blerim Vela, Petrit Hysaj, Maria Berishaj, nga MSHP-Brikena Mulliqi, Safet Thaçi, nga KDI - Valon Hyseni, Isuf Zejna, nga QKZ - AIE-Besfort Rrecaj, Jeton Bytyqi, Avni Zuka - NDI, Arsim Avdiaj - KK dhe Federike Wünschmann.

I ftuar: ministri i Shërbimeve Publike, Arsim Bajrami.

Nga stafi mbështetës i Komisionit: Ahtere Loxha dhe Adelina Demolli.

Mbledhjen e kryesoi Džezair Murati - zëvendëskryetar i parë i Komisionit.

Për këtë mbledhje është propozuar ky rend dite:

- 1. Miratimi i Rendit të ditës;**
- 2. Prezantimi i dr. Arsim Bajramit – ministër i Shërbimeve Publike, lidhur me reformën e administratës publike në Kosovë;**
- 3. Shqyrtimi i Projektligjit për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit nr. 2003/7, për lëndën arkivore dhe arkivat me amendamentet e Komisionit Funkcional në aspektin e pajtueshmërisë me legjislacionin e BE-së;**
- 4. Të ndryshme.**

*Kryesuesi konstatoi se janë plotësuar kushtet dhe e hapi mbledhjen lidhur me shqyrtimin e pikës së parë të rendit të ditës.*

## **1. Miratimi i rendit të ditës**

*Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.*

## **2. Prezantim i dr. Arsim Bajramit – ministër i Shërbimeve Publike, lidhur me reformën e administratës publike në Kosovë**

**Kryesuesi** - E falënderoi ministrin për pjesëmarrje dhe e ftoi ministrin që t'i paraqesë reformat e administratës publike të Kosovës.

**Arsim Bajrami** – E falënderoj për ftesën e bërë nga Komisioni, sepse e konsideroj si të rëndësishme pasi tema është e përfshirë në programin e integritimeve evropiane nga ana e Qeverisë së Kosovës. Ai e bëri një paraqitje lidhur me gjendjen dhe reformën e administratës publike, për të arriturat në zbatimin e planit të veprimit dhe për disa kahe themelore të bëra nga MPSH-ja. Tha se Administrata publike është pasqyrë e performancës së një shteti, shtyllë e rëndësishme për ta ndërtuar një administratë apolitike, profesionale, publike. Kosova e ka filluar ndërtimin e këtij procesi menjëherë pas vendosjes së UNMIK-ut dhe kompetencat kanë qenë të përziera deri me shpalljen e Pavarësisë dhe tani kjo sferë e përgjegjësisë është në Qeverinë e Kosovës. Përkushtimi i Qeverisë në këtë drejtim është më i madh se deri më tani. Jemi në rrumbullakësim e sipër me kornizë ligjore sa i përket reformës. Ligji kryesor është për Qeverinë e Republikës së Kosovës që është në fazën finale. Ai e ka marrë parasysh projektin Britanik që eliminon struktura të dyfishta dhe do t'i zëvendësojë rregulloret e deritashme të UNMIK-ut. Ky ligj do të krijojë qeveri funksionale, moderne me mandat kushtetues. Me Kuvendin ka raporte kushtetuese dhe raportohet në periudha kohore. Qeveria do të funksionojë si ekip kabinetik me rol dominant të kryeministrit. Përpos ministrive dhe ministrave aktualë do të ketë ministra parësorë - duke shkuar nga metoda elektronike e punës. Ligji i dytë është për shërbyesit civilë që është shumë i rëndësishëm. Do të ketë rregulla të qarta të menaxhimit të shërbimeve civile për t'i mbrojtur shërbyesit civilë.

Ligji tjetër është ai për pagat që do ta vendosë nomenklaturën unike të pagave në shkallë shteti. Këto 3 ligje së shpejti do të dorëzohen në Kuvendin e Kosovës dhe do të na mundësojnë të kemi pasqyrë të qartë të administratës publike.

Jemi duke bashkëpunuar me shumë shtete në këtë drejtim. Kemi arritur shumë marrëveshje bashkëpunimi që të asistojnë në reformimin e administratës publike. Me Këshillin Britanik jemi duke e realizuar rishikimin horizontal dhe vertikal. Rishikimi përfshin analizën e funksionalitetit të të gjitha segmenteve të Qeverisë dhe në bazë të kësaj analize do të kemi mundësi të shohim se çka është duke funksionuar mirë dhe çka duhet ndryshuar në administratën publike. Kosova duhet ta ketë një administratë publike dhe një strukturë kompaktibile me zhvillimin ekonomik të Kosovës. Administrata publike në Kosovë ka 75.000 të punësuar, që është konstatuar nga ndërkombëtarët se është numër më i madh seç i duhet Kosovës, por për shkak të gjendjes sociale Qeveria nuk e ka në plan shkurtimin e numrit, por me trajnime të vazhdueshme të reformimeve në

administratën publike zyrtarët të përgatiten me metoda të reja të menaxhimit të punëve publike. Kemi filluar me qeverisjen elektronike. Strategjia nacionale për qeverisje elektronike parasheh që deri në vitin 2015 e tërë Kosova ta zbatojë këtë sistem që të ketë vendim marrje elektronike. Qeverisja elektronike është sistem i qeverisjes së mirë dhe transparente. Kemi marrëveshje bashkëpunimi me Slloveninë dhe me Estoninë, shtete të BE-së. Në këto dy shtete ka funksionuar shumë mirë ky sistem. I kemi dërguar 2 grupe të zyrtarëve për trajnim. Në vazhdim theksoi se problemi kryesor i administratës publike është depolitizimi. Është problem me të cilin sfidohet suksesi i shtetit të Kosovës, prandaj jemi duke punuar të krijohet një imazh që administrata publike të jetë për qytetarët e Kosovës e jo për shtetin e Kosovës. Në këtë drejtim kemi arritur ta pavarësojmë Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës që ka qenë në kuadër të MPSH-së që i mbikëqyr politikat e rekrutimit të shërbyesve civilë, që tani është i lidhur me Kuvendin e Kosovës dhe është në fazën e përzgjedhjes së anëtarëve të kësaj këshilli. Segment tjetër i reformimit është reformimi KELP-it, që është një mekanizëm për emërime të larta dhe ka funksionuar si mekanizëm i kombinuar. Tani jemi në fazën që ta reformojmë këtë mekanizëm që do ta reflektojë gjendjen e re. MPSH-ja është duke punuar në disa procese të vazhdueshme në planin e komunikimit masiv të qytetarëve në mënyrë që në vitin 2009 të fillohet me komunikimin elektronik me qytetarët. Kjo do ta rritë transparencën e institucioneve në komunikim me qytetarët dhe do ta bëjë të arritshme listën e të gjitha dokumenteve që nuk janë sekret shtetëror. Qeveria së shpejti do ta krijojë ministrinë e administratës publike që do t'i eliminojë paqartësitë e kompetencave dhe do të ketë strategji të qarta.

Gjatë diskutimit të tij u përqendrua edhe në disa dukuri negative të vërejtura në administratën publike, si në nivelin komunal, ashtu edhe në atë qendror të administratës publike duke thënë se janë bërë rekrutime jashtë rregullave të Ligjit për shërbyesit civilë. MPSH ka intervenuar dhe ka kërkuar të korrigjohen ato vendime që janë në kundërshtim me rregullat e shërbimit civil. Ka pasur edhe disa veprime, si problemi i sekretarëve permanentë, që nuk janë menaxhuar në pajtim me rregullat e shërbyesve civilë. Në kuadër të Ligjit për Qeverinë do ta krijojmë një konsensus të përgjithshëm për të. Lidhur me këtë Qeveria i ka dy praktika evropiane, njëra sugjeron që pozita e sekretarit të mbetet si pjesë e stafit civil. Në disa shtete të BE-së pozitën e sekretarëve e ngrenë në shkallën e të emëruarve politik. Ne jemi duke diskutuar të dy opsionet dhe Kuvendi do ta thotë fjalën e fundit lidhur me këtë. Po raportojmë vazhdimisht për progresin në administratën publike në Programin e partneritetit me BE-në. Reforma e administratës publike është një proces i përhershëm që asnjëherë nuk do të përfundojë dhe asnjëherë nuk duhet të ndalet, që duhet të synojë standardizimin me BE-në. Deri me 2011, Kosova, do t'i plotësojë këto kritere, jo vetëm në aspektin legjislativ, por edhe me praktika të veprimit, praktika të mbrojtjes dhe me praktika të efikasitetit të administratës publike. Administrata publike është pasqyra e vërtetë e një shteti. Për ta parë shkallën e demokratizimit të një vendi, duhet të shihet sa është efektiviteti i administratës dhe sa është ajo në shërbim të qytetarëve, sa është niveli i komunikimit me qytetarë, niveli i profesionalizimit dhe niveli i politizimit. Ne, si Qeveri, jemi të vendosur ta ndërtojmë një administratë efektive, racionale që do të kryejë shërbime për qytetarët dhe një administratë maksimalisht të depolitizuar. Në fund tha se si këtë komision, po ashtu edhe atë të Shërbimeve publike brenda Kuvendit, jemi të gatshëm ta informojmë në mënyrë të rregullt. Në Kuvendin e Kosovës së shpejti do të diskutohet për gjendjen e administratës publike dhe pastaj

opinionet e këtyre dy komisioneve dhe të Kuvendit do të shërbejnë si udhërrëfyes drejt finalizimit të projekteve që Qeveria do t'i miratojë dhe do t'i dorëzojë në Kuvend.

**Zylfije Hundozi** – E falënderoi ministrin për ekspozenë e paraqitur për reformat në administratë dhe pyeti a ekziston zyra e statistikave? Tha se në vizitën që e bëmë në Bruksel janë ankuar se në Kosovë nuk ka statistika adekuate në bazë të të cilave do të vlerësohej progresi i arritur.

**Arsim Bajrami** - Tha jemi duke tentuar që Zyrën e Statistikave ta shndërrojmë në agjenci të pavarur. Lidhur me funksionimin e kësaj zyre tha se kemi probleme të trashëguara dhe nuk kemi të dhëna të sakta statistikore. Njoftoi se që tri vjet Kosova po e kërkon të drejtën që ta regjistrojë popullsinë, por është shtyrë kjo çështje deri në zgjidhjen e statusit, ndërsa tani jemi në prag të një vendimi politik, por duhet të koordinohemi edhe me mekanizmat ndërkombëtarë, sepse edhe Pakoja e Ahtisarit është marrë me çështjen e regjistrimit të popullsisë dhe ka një nen në të cilin thuhet se regjistrimi i popullsisë do të bëhet një vit pas hyrjes në fuqi të Pakos së Ahtisarit. Shtoi se çdo muaj publikohen të dhëna statistikore për fushat e ndryshme. Sa i përket funksionimit të Entit të Statistikave, tha jemi duke rekrutuar një menaxhment të ri dhe si objektiv të parë e kemi regjistrimin e popullsisë. Njoftoi se muajin e kaluar ishte takuar me drejtorin e Eurostatit (Agjenci e BE-së për gjendjen e statistikave) që e ka koordinuar punën e regjistrimit të popullsisë dhe të ngritjes së një agjencie të nivelit evropian. Shtoi se në muajin nëntor agjencia statistikore do ta bëjë regjistrimin testues në pesë komuna ku jetojnë edhe pakicat për ta parë shkallën e pjesëmarrjes së tyre. Njoftoi se Qeveria e Kosovës 15 prillin e ka caktuar si datë e fillimit të regjistrimit të popullsisë, kurse 1 majin kohë të përfundimit të tij. Po ashtu Agjencia Kadastrorë tha se është një institucion shumë i rëndësishëm për Kosovën. Tërësisht u rrënuar pas luftës, kurse tash po rindërtohet me metoda bashkëkohore dhe gati po kompletohet aparati kadastror i Republikës së Kosovës.

**Hydajet Hyseni** - Tha se ka hapësirë të gjerë bashkëpunimi ndërmjet kësaj ministrie dhe Komisionit. Kemi problem me harmonizimin e legjislacionit dhe po përballemi me vështirësi të mëdha në këtë drejtim. Pasi ministritë kanë njësi ligjore për harmonizim, ai kërkoi të bëhet specifikimi i fushave që kanë të bëjnë me *acquis communautaire*. Në këtë mënyrë do të ndihmohej Komisioni në punën që e bën. E konsideroi shumë të dobishëm ristrukturimin e Qeverisë. Tha se duke i respektuar specifikat që i ka Kosova të kihet parasysh mundësia që edhe Kosova të ketë një ministri të integritimeve evropiane, sepse në vendet e rajonit është dëshmuar si një mekanizëm shumë i nevojshëm dhe i dobishëm. Kosova veçohet për numër të madh të mërgimtarëve që përbëjnë faktor shumë të rëndësishëm edhe ekonomik. Do të ishte e arsyeshme të kishte një resor të veçantë për mërgatën, ku do të mund të rregullohej edhe çështja e kthimit. Shtoi se kemi një ministri për kthim të komuniteteve, kurse ne kemi një zyrë për kthim të refugjatëve tanë, por me këtë po bëhet ndarje në baza etnike dhe kjo është pa precedencë dhe pa logjikë. Shumë i dobishëm është racionalizimi i sistemit të pagave, pasi është koha që disa paradokse të pagave të ndërpriten. Si shembull tha e kemi Bordin e Pensionistëve, atje ku flitet për pensione të mjeruara, ndërsa këtu flitet për paga marramendëse. Deri tani është thënë se

nuk është ne kompetencën tonë, por tash e tutje duhet të merren masa të rrepta që kjo çështje të zgjidhet. Me këtë tha do të kthehet disponimi i qytetarëve të Kosovës.

**Arsim Bajrami** - Sa i përket cilësisë së ligjeve kjo çështje i përfshin edhe Kuvendin edhe Qeverinë. Jemi duke punuar që të gjithë zyrtarët ligjorë ta kuptojnë drejtë legjislacionin evropian. Njoftoi se deri më tani ka më se 500 zyrtarë në IKAP, ku legjislacioni evropian është programi më i kërkuar. Tha se Qeveria i ka formuar dy komisione që udhëhiqen nga zv.kryeministrat: Komisioni për kolizionin e ligjeve dhe Komisionin për harmonizimin e ligjeve. Propozoi që Kuvendi i Kosovës ta formojë një njësit që do ta bënte redaktimin ligjeve para se të publikoheshin në Gazetën Zyrtare. Sa i përket çështjes së pagave tha se ajo është çështje imediate që duhet të rregullohet, sepse opinioni është mjaft i shqetësuar me lajme të ndryshme. Për këtë qëllim kemi ofruar një sistem shtetëror të pagave. Si model është marrë sistemi i Sllovenisë.

**Njomza Emimi** - Tha se e kemi një kaos, sepse sa u përket shërbimeve publike nuk ekziston një informim përkatës se cilat shërbimet ofrohen dhe ku ofrohen. Pyeti: A keni ndonjë strategji apo dokument me anë të të cilit do të zvogëlohej numri i të punësuarve në administratë dhe të rritej efekti i shërbimeve?

**Arsim Bajrami** - Tha termi shërbime publike është tejkaluar në Kosovë, pasi në kohën e transicionit MSHP-ja ka qenë gjysma e Qeverisë, ngase në këtë ministri kanë qenë katër ministri. Tani kjo ministri e ka ndërruar mandatin dhe më nuk ofron shërbime, por është përgjegjëse për administratën e shtetit, sepse shërbimet publike janë bartur te Ministria e Rendit, ndërsa MSHP-ja po specializohet për pesë funksione kryesore: tërheqjen e administratës shtetërore, menaxhimin civil, sistemin e pagave, e-qeverisjen dhe menaxhimin e plotë të godinave. Të gjitha analizat që i marrim nga faktori ndërkombëtar flasin për administratë të stërngarkuar, por duhet të kemi parasysh se administrata jonë është edhe administratë sociale dhe është problematike të bëjmë prerje kirurgjike për të vendosur gjendje normale. Shtoi se sa i përket gjendjes me teknologji informative jemi në nivel më të mirë se disa vende të rajonit dhe së shpejti Kosova do ta ketë portalin shtetëror.

**Naser Rugova**- Tha se Qeveria e Kosovës ka ardhur me vonesë me program, por programi i MSHP-së ka qenë një nga pjesët më të mira të programit. Sa i takon reformës së administratës publike është përfolur shumë se do të bëhet në vitin 2001, por ende nuk u bë asgjë konkrete, ose të arriturat janë simbolike në kundërt nevojave. Tha se Këshilli Britanik që nga viti 2005 ka biseduar intensivisht me institucionet e Kosovës, por vërehet mungesë e vullnetit politik për reforma esenciale të administratës. Deri më tani del se kemi zbatim të ligjit vetëm 30% e siç dihet s'mund të kemi reformim të administratës pa zbatim të ligjit. Pyeti se a keni hartuar organograme të ministrive, pasi anarkia e konfuzioni vijnë si pasojë e mosrespektimit të hierarkisë. Si shembull për këtë e kemi dyfishimin e Zyrës së Kryeministrit me dy ose tri zyra të reja që nuk di a po tentojnë t'i marrin kompetencat e ministrive apo janë themeluar për shkak të mosnjohjes së ngritjes së kapaciteteve të administratave publike moderne? Shtoi se gjatë këtyre dhjetë muajve qytetarët e Kosovës janë të njoftuar për largimet arbitrare nga vendet e punës në komunën e Gjilanit, të Vitisë, të Mitrovicës, të Vushtrrisë dhe së fundit në Prishtinë. Këshilli i

Pavarur Mbikëqyrës do të ketë mija ankesa që kërkohen vite për t'u shqyrtuar. Kjo me siguri se do ta ngarkojë atë dhe do t'i japë notë të keqe para mekanizmave vendorë dhe ndërkombëtarë. Sa i përket e-qeverisjes tha se është kusht esencial që secili shtet që synon anëtarësim në BE ta përqafojë e-qeverisjen. Sa i takon depolitizimit tha se një nga objektivat ekonomikë janë funksionalizimi dhe reformimi i ndërmarrjeve publike në shërbim të ngritjes së cilësisë për qytetarët. Është evidente se 80% e shërfave të prokurimeve janë ndërruar.

**Arsim Bajrami** - Tha se nuk e glorifikova punën e administratës publike, por isha edhe kritik në disa pika. Shtoi se pa një administratë moderne dhe efektive s'mund të shkojmë drejt BE-së. Shtoi se kemi trashëguar një bagazh të madh kaotik në administratën publike. Në Ministrinë që ai e udhëheq nuk ka pasur largime nga puna në baza politike. Njoftoi se Qeveria me një vendim politik do të vendosë për sekretarë permanentë dhe me këtë rast do të ketë shumë ndihmesë për administratë. Sa i përket çështjes së bordeve më parë ato kanë qenë të përbëra nga ministrat dhe zv.ministrat, por kjo qeveri e ka ndërprerë këtë trend ku politika përzihet drejtpërdrejt në borde.

**Edita Tahiri** – Tha se duke i marrë parasysh synimet që të kemi administratë profesionale, efektive politizimi e dëmton shumë punën e administratës, sepse është një skenë politike në administratën publike, kjo është strategjia e depolitizimit, ku nuk ka mundësi për ndërhyrje kirurgjike. Pyeti sa është i pranishëm koncepti i menaxhimit të cilësisë në konceptin e administrimit tonë publik, sepse ka nevojë për një kontroll të cilësisë. Lidhur me grevën e punëtorëve të administratës pyeti a do të ndodhë apo do të mundoheni ta parandaloni? Sa i përket çështjes së pagave tha se ka anomali shumë të mëdha. Disa drejtorë të organizatave publike kanë pasur rroga shumë më të mëdha se njëshi dhe dyshi i shtetit. Sa i përket dallimit ndërmjet rrogës më të madhe dhe asaj më të voglës, tha nuk e di me standardet evropiane sa lejohet të jetë diferenca, por te ne është diferencë shumë e madhe. Po ashtu kemi diferencë shumë të madhe ndërmjet rrogës së udhëheqësve të shtetit dhe deputetëve, përkundër asaj se deputetet janë të zgjedhurit e popullit dhe Kuvendi është instanca më e lartë e shtetit. Meqë po përgatitet ligji për të ardhurat, pyeti a është paraparë që në koeficient të përfshihet edhe puna gjatë kohës së okupimit dhe gjatë kohës së luftës që të reflektojnë në koeficientin e të ardhurave? Duhet të interesohemi që edhe në Ligjin për deputetet t'i rregullojmë çështjet e deputetëve, sepse Kuvendi ishte edhe në dy mandate (1992-1998 dhe 1998-2000). Pra kjo është historia jonë. Nëse ne nuk e institucionalizojmë të tjerët mund të na e heqin.

**Arsim Bajrami** - Tha se depolitizimi është një sëmundje kronike në tërë sektorin publik. Si instrumente për depolitizim tha janë zbatimi konsekuent i Kushtetutës, zbatimi konsekuent i Rregullores për shërbyesit civilë, rritja dhe fuqizimi i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës, ndoshta pak edhe i Gjykatës Kushtetuese. Që të kemi administratë të reformuar nga shërbyesit duhet të kërkohet cilësia e shërbimeve publike e jo vetëm të punojnë punëtorët. Me Ligjin për pagat tha është futur edhe evaluimi i shërbyesve, ku në bazë të cilësisë do të caktohet edhe 20% i pagës. Lidhur me grevat tha se janë evidente. Shtoi se brenda sindikatave ka rivalitet dhe ky rivalitet po vërehet edhe në veprimet e tyre. Njoftoi se është përgatitur pako për përmirësimin e situatës së tyre dhe kjo pako i është ofruar sindikatës. Nesër do të kemi takim me sindikatën. Edhe pse kemi vërejtje nga

Fondi Monetar Ndërkombëtar për numër të madh të të punësuarve në administratë Qeveria do ta fillojë nga janari i vitit të ardhshëm zbatimin e këtyre masave. Lidhur me njohjen e punës edhe gjatë kohës së okupimit dhe të luftës, Qeveria e Kosovës e ka pranuar logjikën e kontinuitetit të punës, por nuk duhet pritur një vendim spektakular, sepse është e pamundur të rregullohen gjërat përnjëherë.

**Nait Hasani** - Tha se kontinuiteti i pagave është interesant kur dihet se kemi pasur raste që kanë qenë të angazhuar në polici. Pyeti bordet a janë shërbyes civilë dhe a do të kenë paga unike apo lineare? Dihet se në Trustin Pensional pagat e tyre arrijnë prej 8 deri në 12 mijë euro. Lidhur me drejtorët e bordeve pyeti a do të kenë më shumë vende pune apo do të kenë vetëm një rrogë nga buxheti i Kosovës? Lidhur me numrin e të punësuarve në administratë për mua tha ishin të ndarë në kategori të ndryshme. Pagat e tyre ndryshojnë, ndërsa të gjithë jetojnë në Kosovë. Lidhur me regjistrimin e popullsisë tha se janë bërë disa testregjistrime, mirëpo nuk ka rezultate se ku janë bërë dhe sa qytetarë janë regjistruar dhe kur do të fillojë regjistrimi i popullsisë.

**Arsim Bajrami** - Tha se anëtarët e bordeve janë shërbyes civilë. Pagat e tyre do të rregullohen me Ligjin për pagat dhe paga e tyre do të jetë e barabartë me sekretarët permanentë. Sa u përket të hollave të Trustit, Qeveria nuk mund të bëjë asgjë deri sa të ndryshohet Ligji. Lidhur me regjistrimin e popullsisë deri më tani dy kanë qenë pengesat kryesore: statusi dhe serbët e Kosovës. Ne po bëjmë gjithçka që serbët të marrin pjesë në regjistrim. Kemi përzgjedhur disa komuna me minoritete në të cilat shpresojmë se do të kemi sukses. Kemi kusht nga BE-ja që pjesëmarrja e serbëve të jetë 30% që të pranohet regjistrimi.

**Sabri Hamiti** - Tha nëse 75 mijë shërbyes civilë janë shumë, nëse nuk largohen për shkak se është administratë sociale dhe organizohen trajnime në mënyrë që të reduktohet stafi, kjo nuk shkon. Lidhur me depolitizimin e administratës do të bëhen përpjekje për depolitizim, por vështirë të arrihet një gjë e tillë. Duhet të synojmë të kemi profilizim dhe profesionalizëm. Pyeti kush po pengon që të bëhet regjistrimi? Njoftoi se edhe në mandatin e kaluar nga Ministria janë bërë përpjekje për ta bërë regjistrimin, por në momentet e fundit nuk është lejuar. A keni në nivel të Qeverisë komision kodifikues, sepse ndërtimi i ligjeve kërkon njohës të mirë të ligjeve? Nuk mund ta bëjnë ligjin ata që s'e njohin ligjin.

**Hydajet Hyseni** - Tha se përmirësimi i ligjeve duhet të bëhet para se të vijë në leximin e dytë.

**Arsim Bajrami** - Tha se jemi administratë e transicionit. Nuk besoj se është hap i mirë nëse zbresim nga 75 në 40 mijë punëtorë, prandaj duhet të kemi strategji për dy apo tri vjet, që kjo qeveri ta vendosë bilancin e administratës publike. Njoftoi se janë duke e bërë kategorizimin e shërbyesve civilë. Kategoria e parë janë shërbyesit civilë klasikë, nëpunësit shtetërorë, shërbyesit civilë me interes të veçantë për Republikën, shërbyesit që ushtrojnë veprimtari deficitare në Republikë dhe të emëruarit politikë. Lidhur me regjistrimin e popullsisë kemi presion politik nga të gjitha zyrat ndërkombëtare që kanë kërkuar që kjo çështje të shtyhet edhe pak. Tani jemi duke biseduar me Pieter Faith. Të

gjithë sektorët publikë janë peng i regjistrimeve. Lidhur me ligjet tha se kodifikimi nuk është fjalë adekuate, por më mirë do të ishte redaktim gjuhësor dhe juridik. Propozoi që brenda Kuvendit të jetë një njësit redaktimi që t'i përmirësojë ligjet para se të vijnë për lexim të dytë. Gjykata Kushtetuese do të jetë si preventivë që ligjet të mos jenë në kundërshtim ndërmjet tyre. Sa i përket legjislacionit tha se jemi në rregull, sepse nuk kemi dispozita diskriminuese.

**Sabri Hamiti** – Tha se e kemi një kushtetutë në fuqi, por sa i përket asaj që është konflikt interesash Kushtetuta jonë i ka dy pjesë: pjesën normative, që i përjashton ato dhe pjesën kalimtare, që i pranon ato. Ky është problem si për Kuvendin e Kosovës, ashtu edhe për institucionet e tjera. Sipas interesave dikush e lexon pjesën normative, të tjerët pjesën kalimtare. Shtoi se në këtë legjislaturë, sidomos Kuvendi e ka të njëjtin përfaqësim dhe të njëjtat detyra qysh i ka pasur edhe para miratimit të Kushtetutës.

**Zylfije Hundozi** - E falënderoj ministrin për raportin e paraqitur para anëtarëve të Komisionit.

**Arsim Bajrami** - Shprehu gatishmërinë të raportojë para Komisionit sa herë që kërkohet një gjë të tillë.

## **2. Shqyrtimi i Projektligjit për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit nr. 2003/7, për lëndën arkivore dhe arkivat, me amendamentet e Komisionit Funkcional në aspektin e pajtueshmërisë me legjislacionin e BE-së**

**Zylfije Hundozi** – E ftoj deputetin Hydajet Hyseni ta paraqesë raportin lidhur me Ligjin nr. 2003/7 për lëndën arkivore dhe për arkivat, me amendamentet e Komisionit Funkcional në aspektin e pajtueshmërisë me legjislacionin e BE-së.

**Hydajet Hyseni** - Tha se çështjet për arkivat dhe lëndët arkivore u janë lënë shteteve anëtare që të vendosin vetë. Prandaj Ligji nr. 2003/7 për lëndën arkivore dhe për arkivat, me amendamentet e Komisionit Funkcional nuk e cenon legjislacionin e BE.

*Komisioni konstatoi dhe e nxori këtë*

### ***Përfundim***

***Komisioni konstatoi se P/ligji për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit nr. 2003/7, për lëndën arkivore dhe arkivat, me amendamentet e Komisionit Funkcional, nuk i cenon parimet themelore të Acquis Communautaire dhe politikat e BE-së.***

## **4. Të ndryshme**

### **a) Rreth Grupeve të Punës të PVPE-ve**

**Zylfije Hundozi** - I njoftoi anëtarët e Komisionit se janë formuar gjashtë grupe pune për PVPE-të dhe i ftoi që ta caktojnë nga një deputet për secilin grup pune, në mënyrë që të shihet për së afërmi puna e secilit grup.

*Kryesuesja konstatoi se Komisioni e nxori këtë*

### ***Përfundim***

*Në mbledhjet e GP do të marrin pjesë deputetët: Hydajet Hyseni - GP për Qeverisje, Fatmir Rexhepi - GP për Ekonomi, Nait Hasani - GP për Tregun e Brendshëm, Edita Tahiri - GP për Infrastrukturë, Njomza Emini - GP për Bujqësi, Naser Rugova - GP për Inovacione dhe Kohezion Social.*

Mbledhja përfundoi në orën 14:20 min.

**Përgatiti**

**Njësia për mbështetjen e Komisionit**

**Kryesuesi i Komisionit**

**Zylfije Hundozi**